



USAID Kosovo Compete Activity Deklarata Vjetore e Programit¹

Nr. i DVP-së: APS-2021-01

Lënda:	Ftesa për dorëzim të Shprehjeve të Interesit përmes Deklaratës Vjetore të Programit të USAID Kosovo Compete Activity (DPV Nr: APS-2021-01)
Qëllimi:	Qëllimi i kësaj DVP-je është që të bëhet ftesë për Shprehje të Interesit nga <i>organizatat e përshtatshme</i> për financimin e qasjeve inovative për ta avancuar objektivin e USAID Kosovo Compete Activity për ta përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme aftësinë konkurruese të sektorëve kryesorë të Kosovës që janë të orientuar kah eksporti: Përpunimi i Drurit, TIK-u dhe Përpunimi i Ushqimit. Organizatat e përshtatshme përfshijnë organizatat e regjistruara ligjërisht në Kosovë dhe në ShBA. Organizatat e vendeve të treta mund të konsiderohen rast pas rasti. <i>Organizatat e përshtatshme për aplikim mund të jenë organizata jofitimprurëse, fitimprurëse dhe joqeveritare.</i>
Lëshuar nga:	USAID Kosovo Compete Activity
Data e lëshimit:	E Enjte, 8 Prill 2021
Data e mbylljes:	E Premte, 31 Dhjetor 2021 në orën 15:00 CET
Shënim:	<i>Inkurajohet aplikimi i hershëm.</i> Për më tepër, USAID Kosovo Compete Activity planifikon të lëshojë Deklarata të ardhshme Vjetore të Programit gjatë ciklit të tij 5-vjeçar.

I. Historik

USAID/Kosovo Compete Activity (këtu e tutje "USAID Compete Activity", "Compete" apo thjesht "Aktiviteti") financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID-i) dhe realizohet nga Cardno Emerging Markets USA, Ltd. (Cardno) si kontraktor kryesor, së bashku me Recura Financials dhe Canopy Lab si nënkontraktorë.

Compete është aktivitet pesëvjeçar i USAID-it (gusht 2020 - gusht 2025) objektivi kryesor i të

¹ Deklarata Vjetore e Programit është ftesë për aplikime e USAID Kosovo Compete Activity ("Compete"), i cili ofron mundësi partneriteti potencial me organizata të përshtatshme për t'i çuar përpara qëllimet kryesore të Compete. Kërkesa synon ta nxisë bashkëpunimin e gjerë midis USAID Kosovo Compete Activity dhe sektorit privat dhe organizatave të tjera të pranueshme për ta përmirësuar sektorin privat dhe aftësinë konkurruese për eksport në sektorët ekonomikë kryesorë. Kjo DVP nuk duhet të shihet vetëm si instrument për grante; fokusi i saj është në angazhimin proaktiv të organizatave të pranueshme në identifikimin e problemeve, definimin e problemeve, përcaktimin e fushëveprimit dhe zhvillimin e zgjidhjeve dhe zbatimin e zgjidhjeve. Duke u bazuar në shqyrtimin e njoftimeve për konceptet e paraqitura, Compete do të vendosë nëse do të kërkojë aplikim të plotë nga ndonjë partner i përshtatshëm në ndonjë aleancë të propozuar për partneritet.

cilit është që ta përmirësojë aftësinë konkurruese të sektorit privat në tregjet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Qasja e Compete ndaj zbatimit bazohet në "zhvillimin e sistemeve të tregjeve (ZhST)". Kjo qasje është pjesë e një qasje të evoluar brenda USAID-it për ta mbështetur zhvillimin e sektorit privat përmes trajtimit të kufizimeve sistemike që e pengojnë vetëqëndrueshmërinë e sistemeve të tregjeve.

Bazuar në qasjen e lartpërmendur, USAID Compete Activity kërkon t'i fuqizojë dhe të lidhë partneritet me kompanitë, organizatat dhe institucionet relevante përmes një qasjeje lehtësuese që i adreson kufizimet sistemike. Duke u larguar nga *ndërhyrjet e drejtpërdrejta në kompani*, qasja ZhST synon ta mbështesë Kosovën që të lëvizë drejt zhvillimit të vetëqëndrueshëm të sektorit privat, duke promovuar sisteme të qëndrueshme të tregut.

USAID Compete Activity përqendrohet në sektorët e mëposhtëm që janë të orientuar drejt eksportit:

1. Përpunimin e Drurit;
2. Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK-un); dhe
3. Përpunimin e Ushqimit.

Puna e USAID Compete Activity, në të gjithë sektorët në fokus të tij, organizohet në pesë fusha funksionale:

Fushat funksionale	Përshkrimi
Qasja në Treg	Lehtësimi i lidhjeve e tregjeve midis kompanive vendore dhe tregjeve rajonale/ndërkombëtare.
Financat e Diversifikuara	Mbështetja e diversifikimit të produkteve financiare në dispozicion për eksportuesit lokalë.
Sofistikimi i Biznesit	Lehtësimi i përmirësimit të sistemeve, strukturave dhe mjeteve të menaxhimit në kompani.
Zhvillimi i Shkathtësive	Mbështetja e përmirësimit të ofrimit të shkathtësive relevante për industrinë.
Mbështetja e Mjedisit të Biznesit	Lehtësimi i përmirësimit të kapaciteteve të akterëve, shoqatave dhe ofruesve të shërbimeve përkatëse institucionale për të ofruar shërbime të përmirësuara.

2. Objektivi dhe qëllimi

Kjo Deklaratë Vjetore e Programit (DVP) ofron *mundësi partneriteti* potencial me organizata të përshtatshme për t'i çuar përpara qëllimet kryesore të Compete. Kjo thirrje synon ta nxisë bashkëpunimin e gjerë midis USAID Kosovo Compete Activity dhe sektorit privat dhe organizatave të tjera të pranueshme për ta përmirësuar sektorin privat dhe aftësinë konkurruese për eksport në sektorët ekonomikë kryesorë. Kjo DVP nuk duhet të shihet vetëm si instrument për grante; fokusi i saj është në angazhimin proaktiv të organizatave të pranueshme në identifikimin e problemeve, definimin e problemeve, përcaktimin e fushëveprimit dhe zhvillimin e

zgjdhjeve dhe zbatimin e zgjidhjeve. Duke u bazuar në shqyrtimin e njoftimeve për konceptet e paraqitura, Compete do të vendosë nëse do të kërkojë aplikim të plotë nga ndonjë partner i përshtatshëm në ndonjë aleancë të propozuar për partneritet.

Përmes kësaj Deklarate Vjetore të Programit, USAID Compete Activity i fton aplikuesit e mundshëm të përshtatshëm t'i dorëzojnë Shprehjet e Interesit (ShEI-të) për të marrë fonde për realizimin e aktiviteteve që i avancojnë objektivat kryesore të Compete Activity. Objektivi kryesor i Compete Activity është që **ta rrisë në mënyrë të qëndrueshme aftësinë konkurruese të sektorëve të përpunimit të drurit, TIK-ut dhe përpunimit të ushqimit të orientuar drejt eksportit.**

Përmes kësaj thirrje, kërkohen ShEI dhe aplikacione nga organizatat dhe subjekte të përshtatshme në të cilat propozohen qasje, zgjidhje dhe metodologji teknike kreative dhe inovative për ta mbështetur objektivin kryesor të USAID Compete Activity.

3. Rezultatet e synuara

Rezultatet e pritura të USAID Compete Activity në të tre këta sektorët janë:

- 1) Sistemet e tregut forcohen për të rritur aftësinë konkurruese të sektorëve; dhe
- 2) Akterët e tregut brenda atyre sistemeve të tregut janë më produktivë dhe më konkurrues.

Gjatë fazës fillestare, USAID Compete Activity ka identifikuar disa kufizime që pengojnë sektorin privat në Kosovë dhe aftësinë konkurruese për eksportim. Disa nga kufizimet kryesore përfshijnë:

- a) Sfidat në qasjen në treg, përfshirë promovimin e kufizuar të eksportit, brendimin e pamjaftueshëm dhe kanalet e kufizuara të shitjes;
- b) Produktet financiare joadekuate në lidhje me eksportuesit;
- c) Modelet e pazhvilluara të biznesit brenda kompanive me struktura të dobëta të qeverisjes dhe menaxhimit;
- d) Qasja e kufizuar në punëtorë të kualifikuar sipas nevojave të industrisë; dhe
- e) Një mjedis i dobët për mbështetje të biznesit me politika publike joadekuate dhe kapacitete të kufizuara nëpër institucionet publike dhe shoqatat e industrisë.

Aplikuesit sipas kësaj DVP-je duhet t'i trajtonë disa nga kufizimet e identikuara me qëllim të rritjes së qëndrueshme të aftësisë konkurruese të sektorëve në fokus të USAID Compete Activity që janë të orientuar drejt eksportit.

Aplikimet e paraqitura sipas kësaj ftese duhet të synojnë ta avancojnë qëllimin e përgjithshëm të USAID Compete Activity dhe t'i kontribuojnë së paku njërit nga indikatorëve të mëposhtëm të rezultateve të Aktivitetit:

- ta rrisin vlerën neto të eksporteve;
- t'i rrisin vendet e punës, përfshirë për gratë, të rinjtë dhe pakicat;
- t'i përmirësojnë lidhjet afariste midis kompanive kosovare dhe blerësve ndërkombëtarë; dhe

-
- ta rrisin vlerën e investimeve të sektorit privat dhe publik.

Aplikuesit inkurajohen të propozojnë *qasje inovative*, por të *qëndrueshme* ndaj trajtimit të çështjeve të lartpërmendura dhe arritjes së rezultateve për t'i realizuar objektivat e Aktivitetit. Gjatë hartimit të qasjes dhe konceptit për aktivitetet e grantit, aplikuesit duhet ta shqyrtojnë shkallën në të cilën aktiviteti dhe qasja e propozuar e grantit do t'i trajtojnë problemet/çështjet e deklaruara apo të identifikuar, pastaj objektivat e USAID Compete Activity që janë përshkruar lart, dhe të sjellin rezultate të verifikueshme që u kontribuojnë indikatorëve të USAID Compete Activity.

4. Fushat prioritare për financim

Fushat që janë renditur më poshtë e ofrojnë një kornizë në kuadër të së cilës palët e interesuara duhet ta mendojnë aplikimin. Megjithatë, *siç është përmendur në Seksionin 5 të këtij dokumenti*, USAID Compete Activity *gjithashtu* i mirëpret aplikimet që mund të dalin jashtë kuadrit që është paraqitur në këtë Seksion (Seksioni 4) për sa kohë që aplikime janë në përputhje me, ose avancojnë, objektivin e përgjithshëm të USAID Compete Activity për ta rritur aftësinë konkurruese të sektorëve në fokus të tij që janë të orientuar drejt eksportit. Në disa raste, posaçërisht kur përfshihet diaspora, USAID Compete Activity mund t'i marrë në konsideratë edhe aplikimet jashtë sektorëve që janë në fokus të tij.

Qasja në Treg

- Mbështetja për zgjerimin e kanaleve të shitjeve, që udhëheqen nga diaspora, në tregjet kryesore rajonale dhe evropiane të eksportit.
- Mbështetja e promovimit të potencialit eksportues të Kosovës përmes ekspozitave/kanaleve (“showrooms”) virtuale.
- Mbështetja e partneriteteve për të lehtësuar bartjen e njohurive praktike të diasporës për t'i përmirësuar lidhjet e eksportit dhe aftësinë konkurruese.
- Mbështetja për gratë pronare të bizneseve përmes programeve të mentorimit me gratë nga diaspora.
- Lehtësimi i mbështetjes për ofruesit e këshillimeve për biznes për ta përmirësuar disponueshmërinë e shërbimeve dhe produkteve të konsulencës për depërtim në tregun e eksportit.
- Mbështetja e krijimit të një Portali të Eksportit për të ofruar shërbime relevante të informatave të tregut dhe këshilla afariste për eksport.
- Mbështetja e krijimit të qendrave të eksportit (“export hubs”) të bazuara në produkte për ta zgjeruar depërtimin e eksportit.
- Përmirësimi i qasjes së përpunuesve lokalë tek bizneset e françizave, veçanërisht në sektorin e hoteleve, restoranteve dhe kafeneve (HoReKa-s).
- Përmirësimi i qasjes së përpunuesve lokalë të ushqimit brenda Kosovës në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të supermarketeve.

Financat e Diversifikuara

- Prezantimi, zgjerimi dhe/ose diversifikimi i produkteve financiare dedikuar kompanive të orientuara drejt eksportit në sektorët e përpunimit të drurit, TIK-ut dhe përpunimit të ushqimit.
- Masat për t'i përmirësuar kapacitetet e brendshme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), duke e mundësuar zhvillimin e brendshëm dhe investimet e mundshme nga jashtë (përmes partneriteteve, ndërmarrjeve të përbashkëta, pjesëmarrjeve në kapital, etj.).
- Mbështetja e partneriteteve dhe nismave për t'i inkurajuar investimet e diasporës në aktivitete afariste që përqendrohen në eksport.
- Mbështetja e prezantimit të produkteve dhe/ose zgjidhjeve të përshtatura të financimit me kosto efikase, që i përmirëson më tej kapacitetet e prodhimit/shërbimit të NVM-ve të orientuara drejt eksportit në sektorët e përpunimit të drurit, TIK-ut dhe përpunimit të ushqimit.
- Lehtësimi i aktiviteteve dhe/ose zgjidhjeve që e synojnë fuqizimin e grave, të rinjve dhe pakicave në sektorët e përpunimit të drurit, TIK-ut dhe përpunimit të ushqimit.

Sofistikimi i Biznesit

- Mbështetja e krijimit të Portalit të Transparencës së Bizneseve (BTB).²
- Promovimi i ndryshimit të menaxhimit të biznesit duke u bazuar në parimet e qeverisjes së korporatave dhe menaxhimit të korporatave.
- Mbështetja e kompanive me potencial të lartë që janë të orientuara drejt eksportit, për ta përmirësuar gatishmërinë për investime dhe për ta tërhequr financim të jashtëm.
- Mbështetja e kompanive për marrjen e çertifikimeve qenësore që ndërlidhen me aftësinë konkurruese për eksport.
- Mbështetja e platformave të menduarit për dizajn (“design thinking”) për t'ua mundësuar kompanive të TIK-ut që të dizajnojnë produkte dhe shërbime relevante për industrinë e përpunimit të drurit dhe të ushqimit.
- Përmirësimi i kapaciteteve për montimin dhe instalimin e mobilieve në tregun final.³

² Krijimi i një platforme të shëndoshë dhe funksionale të marketingut është prioritet kyç për kompanitë kosovare të angazhuara në eksport dhe kështu qëllim qenësor i USAID Compete Activity në Kosovë. Prioritet në këtë aktivitet është promovimi i B2B-ve përmes mbështetjes për kompanitë që mëtojnë ta avancojnë aftësinë konkurruese dhe aktivitetet e eksportit. Kjo platformë online do t'ua mundësojë kompanive kosovare që t'i përfaqësojnë më mirë interesat e tyre brenda dhe jashtë vendit. Lidhjet dhe aftësitë e avancuara do ta përmirësojnë qasjen në informata, do të sjellin zhvillim dhe do t'u ofrojnë mundësi të reja kompanive anëtare (të listuara në Portal). Veç kësaj, kjo platformë do t'i promovojë marrëdhëniet me klientët, distributorët dhe partnerët ekzistues dhe të rinj përmes një platforme të vetme në internet. BTB gjithashtu synon të shërbejë si platformë e rëndësishme për t'i promovuar nismat biznes me biznes (B2B).

³ Aktivitetet në këtë fushë kanë për qëllim mbështetjen e kompanive të drurit që tashmë eksportojnë, posaçërisht në tregun e BE-së, por që kanë nevojë për mbështetje profesionale në segmentin e kapaciteteve për instalim dhe montim të mobilieve. Qëllimi kryesor i USAID Compete Activity është që të lehtësojë lidhjen e prodhuesve të drurit në Kosovë me përfaqësues të besueshëm të nënsektorit në tregun e BE-së me shërbime të specializuara të mobilieve. Në bashkëpunim të ngushtë me ShPDK-në, Compete do ta angazhojë një ofrues të shërbimeve jashtë vendit për t'i

Zhvillimi i Shkathësive

- Lehtësimi dhe mbështetja e nismave të udhëhequra nga sektori privat për ta përmirësuar disponueshmërinë e arsimit dhe aftësisë profesionale (AAP-së) i cili është relevant për sektorët e Compete.
- Mbështetja e promovimit të arsimit dhe karrierës në sektorët e fokusit të Compete në mesin e grave, të rinjve dhe pakicave.
- Mbështetja e partneriteteve të udhëhequra nga sektori privat nga ofruesit e arsimit për ta hartuar dhe ofruar një program ekzekutiv për inovacionin dhe dizajnin e produkteve arkitekturore dhe të interierit.

Mbështetja e Mjedisit për Biznes

- Lehtësimi dhe mbështetja e forcimit të funksioneve kryesore të shoqatave të industrisë (në sektorët e Compete), në mbështetje të përmirësimit të aftësisë konkurruese për eksport.
- Mbështetja e partnerëve lokalë për t'i themeluar dhe përmirësuar entitetet e çertifikimit që mund të ofrojnë shërbime të çertifikimit për industrinë lokale.

5. Fushat e tjera të financimit

Siç u tha, USAID Kosovo Compete Activity do të jetë gjithashtu i hapur për t'i shqyrtuar dhe vlerësuar propozimet e tjera që dalin jashtë suazave të prioriteteve kryesore që janë përshkruara në Seksionin 4 më lart. USAID Compete Activity do t'u ofrojë mundësi aplikuesve, partnerëve dhe akterëve të tjerë që të paraqesin ide të financueshme që janë inovative, me ndikim dhe në përputhje me objektivin e përgjithshëm të USAID Compete Activity për ta përmirësuar sektorin privat dhe aftësinë konkurruese për eksport në sektorët e fokusit të përpunimit të drurit, përpunimit të ushqimit dhe TIK-ut. *Në rastin e propozimeve që ndërlidhen me diasporën, USAID Compete Activity do të jetë i hapur për shqyrtimin dhe financimin (rast pas rasti) e propozimeve inovative, të qëndrueshme dhe me ndikim që mund të dalin jashtë sektorëve të fokusit të Compete.*

6. Madhësia e grantit

Varësisht nga disponueshmëria e fondeve, USAID Compete Activity synon të japë grante për t'i financuar aplikimet e përshtatshme që i avancojnë objektivat e Compete dhe sjellin rezultate në mbështetje të këtyre objektivave.

Çdo grant i dhënë që rezulton nga kjo thirrje pritet të jetë në vlerë prej:

- **EUR 10,000** deri në **EUR 100,000**

Periodha e realizimit të aktiviteteve të financuara është më së shumti 3 vjet.

mbështetur prodhuesit e mobileve në Kosovë me trajnime për zbatimin e standardeve të montimit në tregjet kryesore të mobilieve të BE-së (dhe Zvicrës).

7. Përshtatshmëria/Pranueshmëria

Të gjitha grantet që jepen nga fondet e USAID Compete Activity do t'u nënshtrohen kriterëve të pranueshmërisë që janë paraqitur më poshtë. Organizatat e përshtatshme duhet të jenë:

- Subjekte, institucione apo organizata të regjistruara sipas ligjit dhe me seli në Kosovë apo ShBA. Organizatat në vendet e treta mund të merren në konsideratë rast pas rasti.
- Organizatat jofitimprurëse/OJQ-të, shoqatat dhe odat afariste, agjencitë e zhvillimit rajonal, institucionet arsimore publike (institutet, shërbimet e zgjerimit, etj.), ose organizatat tregtare dhe/ose fitimprurëse që e kuptojnë se asnjë fitim apo tarifë nuk do të lejohet sipas marrëveshjes për grant.

Organizatat e përshtatshme/pranueshme po ashtu duhet të:

- Demonstronjë aftësi për t'u kontribuar objektivave të USAID Compete Activity dhe për ta realizuar grantinsipas parimeve dhe praktikave të USAID-it dhe Cardno-s.
- Shfaqin menaxhim të shëndoshë financiar, administrativ dhe teknik në formën e një sistemi të kontrollit që i mbron pasuritë dhe mbron nga mashtrimet dhe humbjet.
- Kenë një histori të performancës së kënaqshme dhe histori të integritetit dhe etikës së biznesit.
- Të jenë në gjendje t'i vërtetojnë dhe nënshkruajnë të gjitha çertifikatat e detyrueshme (që janë renditur në **shtojcën A**)

Organizatat e papërshtatshme/papranueshme përfshijnë:

- Individët.
- Partitë politike ose institucionet.
- Organizatat që avokojnë, promovojnë apo përkrahin politika antidemokratike apo veprimtari të paligjshme.
- Organizatat që synojnë që fondet t'i përdorin për qëllime fetare.
- Subjektet që i kanë keqpërdorur fondet e USAID-it në të kaluarën.
- Subjektet që janë në listën e palëve që janë përjashtuar nga programet federale të prokurimit dhe joprokurimit apo të Komitetit për Sanksione të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara apo që kanë pronarë apo menaxherë që janë përjashtuar në këtë mënyrë.

Para dhënies së grantit sipas kësaj DVP-je, nga aplikuesit e suksesshëm do të kërkohet që ta nënshkruajnë një Vërtetim lidhje me Financimin e Terrorizmit ku vërtetohet se organizata e aplikuesit nuk u jep dhe nuk u ka dhënë kurrë ndihmë terroristëve për aktivitete terroriste. Nga aplikuesit e suksesshëm gjithashtu mund të kërkohet që të nënshkruajnë vërtetime të tjera të zbatueshme për grantin. Vërtetimet janë bashkangjitur si **shtojca A** e kësaj DVP-je.

Para dhënies së grantit sipas kësaj DVP-je, aplikuesit e suksesshëm do t'i nënshtrohen gjithashtu një *përcaktimi të përgjegjësisë para dhënies së grantit*, i cili do të bëhet nga USAID Compete Activity. Gjatë këtij përcaktimi, USAID Compete Activity do të përcaktojë nëse aplikuesi e ka kapacitetin organizativ, kapacitetin financiar, kontrollet e brendshme, sistemet e prokurimit (nëse kërkohen)

dhe evidenca të performancës së tij në të kaluarën për t'i realizuar me sukses aktivitetet e grantit. Vetëm organizatat që përcaktohet se janë të përgjegjshme do të jenë të përshtatshme për dhënie të grantit.

Nuk do të merret në konsideratë asnjë aktivitet që ka ndikim negativ në mjedis që nuk mund të zbutet.

USAID Compete Activity do të japë grante që i trajtojnë problemet specifike dhe ofrojnë zgjidhje praktike, duke i inkurajuar aplikantët të ofrojnë bashkëfinancim dhe një analizë të qëndrueshmërisë së aktiviteteve të grantit.

Aplikuesit *inkurajohen fuqishëm* që t'i ndajnë shpenzimet e realizimit të aktiviteteve të propozuara të projektit/aktiviteteve. Aplikuesit që propozojnë participim të arsyeshëm do të kenë pikë shtesë në vlerësimin e aplikacioneve të tyre.

Grantmarrësit inkurajohen që të japin kontribute në mallra, por, meqë ato nuk nënkuptojnë shpenzim parash për ta, ato nuk do të trajtohen si bashkëfinancim. Kontribut "në mallra" nënkupton investimet që bëhen në formë të mallrave dhe shërbimeve, e jo në formë të parave.

8. Shprehjet e Interesit dhe Aplikimet e Plota për Grant

Kjo ftesë nënkupton një proces të aplikimit dhe vlerësimit në disa faza.

Faza 1: Shprehja e Interesit: Gjatë fazës së parë, nga aplikuesit kërkohet që ta dorëzojnë një Shprehje të Interesit (ShEI), ku përshkruhet natyra e problemit që synojnë të trajtojnë, rëndësia e aktiviteteve të propozuara karshi qëllimeve të USAID Compete Activity, përshkrimi i aktiviteteve dhe detyrave kryesore të propozuara, rezultatet e pritura, plani i menaxhimit, përvoja e mëparshme relevante e aplikuesit dhe një buxhet fillestar i propozuar. Në ShEI duhet të shpjegohen qartë dhe në mënyrë koncize qëllimi, relevanca, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të aktivitetit të grantit në mbështetje të objektivave të USAID Compete Activity, siç janë paraqitur në nenet 2 dhe 3 të kësaj ftese. Të gjitha ShEI-të duhet të dorëzohen në formatin e ShEI-së që është përfshirë në **shtojcën B** të kësaj ftese dhe nuk t'i kenë më shumë se 5 faqe.

ShEI-të mund t'i dorëzohen USAID Compete Activity në çdo kohë para datës dhe kohës së mbylljes që është saktësuar në këtë ftesë. ***Megjithatë, inkurajohet aplikimi i hershëm.*** Aplikuesit duhet t'ia dorëzojnë ShEI-të me shkrim Menaxherit të Granteve dhe Nënkontratave të USAID Compete Activity në mënyrë elektronike, përmes postës elektronike në grants@kosovocompete.org. Data e fundit për dorëzimin e ShEI-ve është e premtë, 31 dhjetor 2021, , ndërsa koha e fundit për dorëzimin e ShEI-ve është ora 15:00, sipas kohës lokale në Kosovë (koha e Evropës qendrore, CET) më atë datë. ShEI-të që dorëzohen pas kësaj date dhe kohe nuk do të merren parasysh sipas kësaj DVP-je.

USAID Compete Activity do ta mbledhë një Komision për Përzgjedhje të Granteve (KPG) që do t'i vlerësojë ShEI-të e dorëzuara si përgjigje ndaj kësaj ftese në vazhden e arritjes së tyre. ShEI-të do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret që janë përfshirë në Seksionin 9 më poshtë. Nëse ShEI-ja e ndonjërit aplikues pranohet nga KPG-ja, aplikuesi do të ftohet që ta dorëzojë një Aplikim të Plotë për Grant siç është detajuar më poshtë.

Faza 2: Aplikimi i Plotë për Grant: Pas vlerësimit të ShEI-ve, Aktiviteti do t'i ftojë organizatat

që kanë paraqitur ShEI-të e suksesshme që të dorëzojnë aplikimin e plotë për grant duke u bazuar në konceptin dhe qasjen teknike të propozuar në ShEI. Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në Formatin e Aplikimit të Plotë për Grant të përfshirë në **shtojcën C** të kësaj ftese. Në formatin e aplikimit të plotë për grant nga aplikuesit, kërkohet që ta zgjerojnë në detaje aktivitetin e propozuar të grantit, objektivat dhe rezultatet e pritura, duke përfshirë një përshkrim të përfituesve të synuar dhe akterëve kryesorë, një strukturë të propozuar të personelit dhe një buxhet të detajuar të grantit. Aplikimi i plotë për grant nuk duhet t'i ketë më shumë se 15 faqe. Aplikimet me më shumë se 15 faqe mund të mos shqyrtohen nga USAID Compete Activity.

9. Vlerësimi dhe përzgjedhja

USAID Compete Activity do ta mbledhë një Komision për Përzgjedhje të Granteve (KPG) që do t'i vlerësojë ShEI-të e dorëzuara si përgjigje ndaj kësaj ftese në vazhden e arritjes së tyre. KPG-ja do të vlerësojë ShEI-të duke u bazuar në kriteret në vijim:

1. Relevanca për objektivat e USAID Compete Activity: A janë veprimtaria, qëllimet dhe objektivat e propozuara të grantit në përputhje me objektivat e Compete? A i kontribuojnë aktiviteti, qëllimet dhe objektivat e propozuara të grantit arritjes së qëllimeve dhe objektivave të Compete siç janë përcaktuar në DVP?
2. Të kuptuarit e çështjeve kryesore: A demonstroi aplikuesi se i kupton qartë problemet/çështjet kryesore që do t'i trajtojë aktiviteti i propozuar i grantit?
3. Qëllimet dhe objektivat e aktivitetit të grantit: A është qëllimi i përgjithshëm i aktivitetit të propozuar të grantit i artikuluar dhe i arritshëm? A i ka renditur aplikuesi objektivat specifikë që do t'i kontribuojnë arritjes së qëllimit të aktivitetit të grantit? A janë objektivat e arritshme dhe të lidhura me qëllimin e përgjithshëm? A është e qartë se si arritja e qëllimit të përgjithshëm dhe objektivave specifike të aktivitetit të grantit do t'i kontribuojnë zgjidhjes së çështjeve kryesore?
4. Detyrat dhe aktivitetet e propozuara: A propozon aplikuesi aktivitete specifike që janë logjike, reale dhe relevante për qëllimin e aktivitetit të grantit? A do të kenë aktivitetet e propozuara efekt të dukshëm negativ në mjedis?
5. Aspektet gjinore, rinisë dhe pakicave: A i synon aktiviteti komunitetet pakicë? Si i mbështesin aktivitetet e propozuara gratë, të rinjtë dhe/ose pakicat?
6. Rezultatet/rezultatet e pritura: A kanë të bëjnë rezultatet e pritura të aktiviteteve të propozuara të grantit me çështjet kryesore dhe objektivat e përgjithshme të ftesës për grante? A ndërliken rezultatet e pritura drejtpërsëdrejti me ndonjë objektiv specifik?
7. Përvoja e mëparshme: A ka organizata përvojë relevante në të kaluarën në realizimin e veprimtarive të ngjashme?
8. Inovacioni: A është (janë) ideja (të) e propozuar (a) inovative dhe të reja në treg?

Nëse KPG-ja pranon ShEI-në duke u bazuar në kriteret lartpërmendura, USAID Compete Activity do ta njoftojë aplikuesin me shkrim dhe do ta ftojë organizatën që të dorëzojë aplikim të plotë për grant. Afati i fundit për aplikimin e plotë për grant do t'i komunikohet aplikuesit të

suksesshëm pas njoftimit se ShEI-ja i është pranuar. KPG-ja do ta vlerësojë aplikimin e plotë për grant duke u bazuar në kriteret në vijim:

1. Të kuptuarit e çështjeve kryesore (20 pikë): A demonstroi aplikuesi se i kupton qartë problemet/çështjet kryesore që do t'i trajtojë aktiviteti i propozuar i grantit?
2. Qëllimet dhe objektivat e aktivitetit të grantit (20 pikë): A është qëllimi i përgjithshëm i aktivitetit të propozuar të grantit i artikuluar dhe i arritshëm? A i ka renditur aplikuesi objektivat specifikë që do t'i kontribuojnë arritjes së qëllimit të grantit?
3. Rezultatet/rezultatet e pritura (15 pikë): A kanë të bëjnë rezultatet e pritura të aktiviteteve të propozuara të grantit me çështjet kryesore dhe objektivin e përgjithshëm të ftesës për grante? A ndërlidhen rezultatet e pritura drejtpërsëdrejti me ndonjë objektiv specifik? A janë rezultatet të verifikueshme?
4. Detyrat dhe aktivitetet e propozuara (15 pikë): A propozon aplikuesi aktivitete specifike që janë logjike, reale dhe relevante për qëllimin e aktivitetit të grantit? A janë veprimtaritë e propozuara inovative? A do të kenë aktivitetet e propozuara efekt të dukshëm negativ në mjedis?
5. Plani i stafit/menaxhmentit (10 pikë): A i pasqyron plani i propozuar i stafit/menaxhmentit nevojat e stafit/menaxhmentit të aktivitetit të grantit? A propozon aplikuesi ekip me përvojë dhe me shkathësitë e nevojshme për t'i realizuar me sukses aktivitetet e propozuara?
6. Përvoja e kaluar (10 pikë): A ka organizata përvojë relevante në të kaluarën në realizimin e suksesshëm të veprimtarive të ngjashme?
7. Efektiviteti i kostos (10 pikë): Çfarë burimesh ofrohen për shpenzimet e propozuara? Çfarë niveli të bashkëparticipimit propozon organizata? A është buxheti i propozuar realist, i menduar mirë dhe në përputhje me aktivitetet e propozuara? A janë shpenzimet e propozuara të arsyeshme, të lejueshme dhe të alokueshme për grantin? A kontribuon grantmarrësi me participim?

USAID Compete Activity e rezervon të drejtën për ta financuar cilëndo apo për të mos e financuar asnjërin nga aplikimet e paraqitura. Lëshimi i këtij ftese për grante nuk përbën zotim për dhënie të grantit nga ana e USAID Compete Activity, as nuk e obligon Compete që të paguajë për shpenzimet e bëra gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të ndonjë ShEI-je apo aplikimi të plotë për grant. Veç kësaj, Compete rezervon të drejtën që ta refuzojë cilëndo apo të gjitha aplikimet e marra nëse ai veprim konsiderohet se është në interesin më të mirë të qeverisë së ShBA-ve. Aplikimet dorëzohen në risk të aplikuesit; nëse rrethanat e pamundësojnë dhënien e grantit, të gjitha shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit janë në barrë të aplikuesit.

10. Administratimi i grantit

Sipas 2 KRRF 200, nënpjesa E dhe 2 KRRF 700.13, është politikë e USAID-it që të mos e lejojë profitin në kuadër të instrumenteve të asistencës. Megjithatë, të gjitha shpenzimet e arsyeshme, të alokueshme dhe të lejueshme, si direkte, ashtu edhe indirekte, që lidhen me aktivitetin e grantit dhe janë në përputhje me standardet e zbatueshme të shpenzimeve (2 KRRF 200, nënpjesa E për

organizatat jofitimprurëse dhe institucionet arsimore, dhe Rregullorja Federale për Blerjet (RrFB), pjesa 31.2 për organizatat fitimprurëse), mund të paguhen në kuadër të grantit.

Çdo dhënie e grantit pastaj do t'u nënshtrohet afateve dhe kushteve të Kontratës Kryesore për USAID Compete Activity.

II. Shtojcat

- A. Vërtetimet, Garancitë dhe Deklaratat e Tjera të Ofertuesve
- B. Formati i Shprehjes së Interesit
- C. Aplikimi i Plotë për Grant⁴

⁴ Shtojca C përbëhet nga formulari i aplikimit të plotë për grant (formati në Word) dhe formulari i buxhetit (formati në Excel).